

# STATUTI

BO Enterprise

Tirane-Shqiperi

**Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)**

Sot, me datë 06.02.2024, të nënshkruarit :

Z. Fitim Ali Fazlliu , i biri i Aliut dhe i Igaballes, lindur ne 17 Shtator 1976 në Prishtin, me adrese banimi Nebih Gashi nr.34, Kalabria Prishtin 10000 Kosovw, me kombwsi shqiptare, mbajtes i pasaportes me numer personal 523583901.

Z. Kujtim Ali Fazlliu, i biri i Aliut dhe i Igaballes, lindur ne date 17.03.1979 në Prishtin,me adrese banimi Matigona Residence,Florida 76, Prishtin 10000 Kosovw,me kombesi Shqiptare, mbajtes i kartes se identitetit me numer personal 523658652.

Me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me Ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqrit Tregtare "(Ligji i Shoqerive) kemi vendosur te krijojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar BO Enterprise ("Shoqëria") duke nënshkruar këtë Statut te shoqerise.

## **Neni 1.**

### **Emri**

- 1.1 Emri i shoqerise do te jete BO Enterprise ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "sh.p.k.", cili perfaqeson formen ligjore te saj.
- 1.2 Ortaket e shoqerise ("Ortaket") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuota .
- 1.3 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimnet e leshuara nga Shoqeria pavarisht nga menyra e dergimit emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:
  - nga fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar "ose "shpk "
  - Numri i identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj
  - adresa e regjistruar dhe
  - pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, nqs ky rast paraqitet

## **Neni 2 .**

### **Forma Ligjore**

Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"(Ligji i Shoqerive).

### Neni 3.

#### Selia dhe kohezgjatja

- 3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: QUTU Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 3.2 Selia e Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

### Neni 4

#### Kohezgjatja

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të përcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve

## KAPITULLI II

### Objekti

### Neni 5.

#### Objekti i veprimtarisë

#### 5.1 Shoqëria ka për objekt :

Qënder aktiviteti lojra, video, boling, restorant, kafe, ndërtim dhe rikonstrukcion rrugësh, tregtimin me shumicë dhe pakicë të parketeve, material për parket dhe izolues ndërtimi, tregtim me shumicë dhe pakicë, import eksport të artikujve industriale, mobileri, artikuj elektroshtëpiake, abazhure të ndryshme, pajisjeve hidrosanitare, artikujve kozmetike, plastike, duralumin, veshmbathje e konfeksione, prodhime e tregtim të materialeve të ndërtimit, inerte, rere, zhavorr, automjete, makinerive, artikujve ushqimorë, bujqësor e blegtorale, tregtim me shumicë të karburanteve, pikave të servisit, parkim automjeteve, lavazhit, të hoteleve, fshatrave turistike, moteleve si dhe agjensive komisionere, agjensi transport të udhëtareve e të mallrave si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij. Pastrim ambiente shërbimi, banka, qendra tregtare. Punime elektromekanike për ambiente shërbimesh. Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe /ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri në bazë të legjislativës shqiptare. Çdo aktivitet tjetër që lidhet në mënyrë direkt dhe indirekt dhe që i shërben përmbushjes së aktiviteteve si më lart.


### Neni 6

#### Ndryshime

- 6.1 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë Statut.

## KAPITULLI III

5.3 Administratori i Shoqerise do te jet:


Te dhënat e identifikimit	Specimeni i nënshkrimit
Z. Fitim Ali Fazlliu , i biri i Aliut dhe i Igaballes, lindur ne 17 Shtator 1976 në Prishtin, me adrese banimi Nebih Gashi nr.34, Kalabria Prishtin 10000 Prishtine Kosov, me kombsi shqiptare, mbajtes i pasaportes me numer 523658652.	

Neni 6. Te tjera

- 6.1 Cdo eshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete Akt Themelimi, do te rregullohet nga dispozitat e Statutit te Shoqerise, Ligjit per Shoqerite dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.
- 6.2 Ky Akt Themelimi hartohet dhe nenshkrhet nga Ortaket e Shoqerise, sot m dat 06.02.2024 në gjuhën shqipe në kater kopje.

**ORTAKWT THEMELUES TE SHOQERISW**

Z. Fitim FAZLLIU



Z. Kujtim FAZLLIU



## Kapitali Themeltar; Pjeset e Kapitalit Themeltar

### **Neni 7. Kapitali Themeltar**

7.1 Kapitali i Shoqërise do të jetë në total 100 000 (njëqind mijë) leke, ku pjesmarrja e secilit Ortakë të Shoqërisë në kapitalin themeltar të shoqërise është si më poshtë:

Z. Fitim Fazlliu, zoteron një kuotë të barabartë me 51% (pesedhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar të shoqërise, ekuivalente me 51 000 (pesedhjetë e një mijë) Leke vlerë nominale

Z. Kujtim Fazlliu, zoteron një kuotë të barabartë me 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërise, ekuivalente me 49 000 (dyzet e nëntë mijë në natyrë) Leke vlerë nominale

### **Neni 9. Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

9.1. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogelohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të shoqërive.

9.2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave dhe fitimit.

9.3. Pjeset e reja të kapitalit themeltar do të nënshkruhen dhe vlera e tyre nominale do të paguhet plotësisht.

9.4. Zmadhimi i kapitalit nuk do të dobësojë pjeset e interesit të Ortakëve në Kapitalin e shoqërise, përveçse kur Ortaket do të bien dakord ndryshe me vendim unanim të Ortakëve.

- Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuotë të saj. Megjithatë me qëllim zvogelimit të kapitalit të Shoqërise, nëpërmjet vendimit për zvogelimit të kapitalit, Ortaket mund të autorizojnë Administratorin(et) të bëjnë blerjen e kuotave përkatëse dhe të anulohen ato.

### **Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakëve**

10.1. Ortaket janë vetëm ata të cilët zoterojnë kuotat e Shoqërise.

- 10.2. Cdo kuote i jep te drejten e nje vote cdo Ortaku, ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve (Asambleja e Pergjithshme), te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, sikunder te drejttat e parashikuara nga ky Statut, per cdo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligjit te Shoqerive.
- 10.3. Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.
- 10.4. Te drejttat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri per keto Kuota.
- 10.5. Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne pergjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne; Ortaket nuk mbajne pergjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata realizojne ).
- 10.6. Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

#### Neni 11.

#### Transferimi i pjeseve te Kapitalit

- 11.1. Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve.
- 11.2. Ne rast se nje Ortak do te shese, transferoje, ose perdore ne menyra te ndryshme ndonje, disa ose te gjithe kuotat e tij ("Shitesi"), ai duhet qe te marre paraprakisht miratimin e Asamblese se Pergjithshme e cila duhet te vendose me nje shumice qe perfaqeson te pakten 75 % (shtatedhjete e pese perqind).
- 11.3. Shitesi duhet t'i jape Perfituesit nje njoftim me shkrim ("Njoftimi i Shitesit") ne lidhje me qellimin e tij per te shitur nje pjese ose gjitha kuotat. Ne njoftimin e tij, Shitesi do te informoje Perfituesin ne lidhje me:
  - numrin e kuotave qe Shitesi deshiron te shese,
  - cmimin, dhe
  - dispozitat dhe kushtet e shitjes.
- 11.4. Perfituesi duhet qe brenda 90 (nentedhjete) diteve nga dita e neserme e dites kur Njoftimi i Shitesit i jepet Perfituesit, t'i jape nje pergjigje me shkrim Shitesit, ("Pergjigjia e Perfituesit"), ne lidhje me qellim per te blere apo refuzuar blerjen e kuotave te ofruara sipas cmimit dhe kushteve te percaktuara ne Njoftimin e Shitesit. Nese Perfituesi nuk njofton ne menyren e duhur Shitesin, Perfituesi do te konsiderohet qe ka refuzuar blerjen e Kuotave te Ofruara.



- 11.5. Nuk lejohet e drejta e parablerjes te pjeseshme.
- 11.6. Nese Perfituesi tjetër vendos të blejë kuotat e propozuara, Shitesi dhe Perfituesi duhet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve bankare nga dita e nesërme e dites kur Pergjigjia e Perfituesit i jepet Shitesit, të hyjë në një marrëveshje të detyrueshme shit-blerjeje kuotash përpara një noteri publik. Shitesi është i detyruar që të shesë kuotat e ofruara me çmimin dhe sipas dispozitave dhe kushteve të percaktuara në Njoftimin e Shitesit.
- 11.7. Nese Perfituesi kundërshton ose konsiderohet se ka kundërshtuar të blejë kuotat e ofruara që nga kjo ditë Shitesi është i lirë të shesë kuotat e ofruara një pale të trete, por vetëm:
- me një çmim të barabartë ose më të lartë sesa çmimi i parashikuar në njoftimin e shitjes dhe sipas miratimit të gjithë kushteve të Ortakeve të tjera, siç parashikohet në Njoftimin e Shitjes; dhe
  - nëse pala blerëse pranon të bëhet pale dhe për rrjedhojë t'i përmbahet kushteve të Statutit të Shoqërisë apo çdo marrëveshjeje ekzistuese midis Ortakeve.
- 11.8. Shitesi do t'i japë Perfituesit një kopje të marrëveshjes së shitblerjes të perfunduar me palën e trete për shitjen e kuotave të ofruara.
- 11.9. Nëse kuotat e ofruara nuk shiten brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e nesërme e dites kur Shitesi është i lirë të shesë kuotat e ofruara një pale të trete, atëherë e drejta e parablerjes e Ortakut tjetër do të ripërkthehet në lidhje me kuotat e ofruara në të njëjtin gjendje siç ishte përpara se kuotat të ofroheshin për shitje.
- 11.10. Krijohet një "Liber i Ortakeve" ku të gjithë Ortaket mund të regjistrojnë kuotat që ato zoterojnë në Shoqëri. Në mënyrë që të konsiderohen si Ortake, çdo person që siguron zoterimin e një ose më shumë kuota të Shoqërisë duhet të regjistrojë emrin në Librin e Ortakeve.
- 11.11. Çdo hyrje në liber do të tregojë emrin e Ortakut, shumën e kuotës që një Ortak i caktuar zoteron dhe formën e transaksionit nëpërmjet së cilës është siguruar ky zoterim. Libri mbahet nga Administratori(et) e Shoqërisë, të cilët duhet t'i leshojnë një kopje të njëjtit secilit Ortak që e kërkon. Çdo hyrje në liber regjistrohet dhe nënshkruhet nga Administratori(et) i/e Shoqërisë, pasi të paraqitet nga Ortaku përkatës dokumenti që vërteton zoterimin e kuotave prej tij.
- 11.12. Çdo transferim i kuotave do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Shoqërive dhe duhet të regjistrohet pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit.

## KAPITULLI IV

### Asambleja e Pergjithshme

#### **Neni 12.     Kompetencat**

- 12.1     Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 12.2     Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose me nje shumice qe perfaqeson te pakten 75% (shtatedhjete e pese per qind) te kapitalit te Shoqerise ("Shumica e Kualifikuar") ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:
- aprovimin e strategjise se Shoqerise, Planit te Biznesit, planeve finaciare dhe buxhetit;
  - aprovimin e cdo ndryshimi ne vijim ne Planin e Biznesit te Shoqerise dhe ne planet financiare;
  - shperndarjen e fitimeve;
  - pezullimin e aktivitetit te Shoqerise dhe/ose perfundimin, shperberjen apo likuidimin e Shoqerise;
  - ndryshimet, amendimet apo zevendesimet ne aktin e themelimit dhe statutin e Shoqerise;
  - ndryshimin e formes ligjore te Shoqerise;
  - ndryshimin e selise se shoqerise.
  - prezantimin e cdo kerkese per likuidim apo falimentim;
  - krijimin e filialeve;
  - strukturen e brendshme dhe organizimin e Shoqerise;
  - bashkimin me shoqeri te tjera, apo ndarjen dhe shkeputjen e Shoqerise;
  - vleresimin e kontributeve ne natyre, ne mungese te eksperteve vleresues te emeruar, sipas Nenit 68 te Ligjit te Shoqerive;
  - zmadhimin dhe/ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;
  - cdo investim te Shoqerise, shpenzim dhe detyrim qe tejkalon kufijte e vendosura kohe pas kohe nepermjet vendimeve te Ortakeve;
  - zvogelimin e kufijve per te cilat kerkohet aprovimi i shumices se kualifikuar te Ortakeve.
- 12.3     Ne rastet kur vendimi nuk mund te kalohet per shkak se nuk arrihet Shumica e Kualifikuar, kjo nuk duhet te konsiderohet si situatë e pazgjidhshme, dhe Ortaket duhet te lejojne per kete qellim nje periudhe reflektimi prej 14 (katërmbëdhjetë) ditësh. Ne ditën e 15 (pesëmbëdhjetë) Ortaket takohen serish dhe perpiqen te bien dakord per miratimin e vendimit ose, nese eshte i



aplikueshem, cdo vendimi alternativ, me shumice te Kualifikuar. Nese serish, Ortaket nuk arrijne te vendosin me shumice te kualifikuar, atehere zbatohet "zgjidhja emergjente" dhe vendimi miratohet me shumice te thjeshte te votave (dmth 75 %). Zgjidhja emergjente mund te aplikohet vetem ne lidhje me paragrafin (i), (ii), (xiii) dhe (xiv) te Seksionit 12.2.

- 12.4 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose me shumice te thjeshte votash dmth 75 % ne lidhje me te gjitha ceshtjet e tjera te Shoqerise qe jane te specifikuara ne nenin 81 te Ligjit per Shoqerite, te listuara si me poshte:
- (i) emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
  - (ii) percaktimi i shperblimit te auditoreve dhe likuiduesve;
    - mbikqyrjen dhe monitorimin e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori (et) i/e Shoqerise, perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
    - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
    - perfaqesimin e Shoqerise perpara Gjykates si dhe ne ceshtjet gjyqesore kunder Administratorit(eve); dhe
    - ceshtje te tjera te cilat do te parashikohen nga Ortaket.

### **Neni 13. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme**

- Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 herë në vit.
- Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjithe aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet Asamblese, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i



pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

- Ortaket do te organizojne takime me Administratorin(et) cdo tre muaj me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga Administratori(et) gjate ketij tre mujori, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre.
- Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese , duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

#### **Neni 14. Menyra e Thirrjes**

- Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e paraqitura ne nenet e mesiperme 12 dhe 13, nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.
- Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga Administratori (et) ose nga cdo njeri prej Ortakeve.
- Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne seline e nje dege te Tiranes, Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe axhenda perkatese e mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Persa i perket vendimeve qe merren jashte Republikes se Shqiperise, Administratorit(eve) u vihet te dispozicion nje kopje e shkruar e ketyre vendimeve te cilen Administratori(et) e ruajne ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise, qe mbahet ne seline e Shoqerise, nen kujdesin e Administratorit(eve). Ne rast se Asambleja e Pergjithshmenuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithë ortaket bien dakort.
- Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetër ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.
- Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Rezoluta e propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t'u dergohet Ortakeve me poste, korrier, telecopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke i kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim.

Ortakët e cilet nuk janë dakord me rezolutën shprehin me shkrim kundërshtitë e tyre në lidhje me rezolutën dhe i'a kthejnë atë Administratorit(ve) të Shoqërisë. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nëse aprovohet nga shumica e kërkuar në përputhje me Seksionin 12, me sipër.

- Secili prej Ortakëve ka të drejtën e të paktën 1 vote; çdo kuota përfaqëson një vote.
- Vendimet e Ortakëve të marra në përputhje me këtë statut si dhe me Ligjin për Shoqëritë do të jenë të detyrueshme për Shoqërinë. Çdo vendim i tillë mund të merret gjithashtu jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe evidencë me shkrim e këtij vendimi do t'i dorëzohet Administratorit(ve) që do ta regjistrojë në librin e vendimeve të Ortakëve të Shoqërisë.
- Ateherë kur ligji e kërkon këtë, rezolutat e Ortakëve duhet të noterizohen nga një noter publik Shqiptar. Në rast se këto rezoluta miratohen jashtë Republikës së Shqipërisë, ato duhet t'i nënshtrohen kërkesave të ligjit Shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Republikën e Shqipërisë (dmth duhet t'i nënshtrohen procedurës së superlegalizimit ose apostilimit, në varesi të vendit ku leshohen).
- Ortakët do të njoftohen për Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve dhe përmbajtjen e axhendës së takimit.
- Administratori (et) duhet të mbajnë procesverbalet e çdo mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me kërkesat e nenit 90 të Ligjit të Shoqërive.

#### **Neni 15      Perjashtimi nga e drejta e votes**

- Një ortak përjashtohet nga e drejta e votes në rastin kur Asambleja e Përgjithshme është duke vendosur mbi:
  - (i)      Vlerësimin e veprimtarisë së këtij Ortaku.
  - (ii)     Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
  - (iii)    Ngritjen e një padie kundër tij, nga Shoqëria.
  - (iv)    Dhenien ose jo të përfitimeve të reja.

15.2 Kur ky Ortak është i përfaqësuar nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi sikundër ortaku të cilin përfaqëson.

## **KAPITULLI V**

### **Administrimi dhe Përfaqësimi**



**Neni 16. Administratori (et) dhe kompetencat**

- 16.1 Shoqeria drejtohet dhe perfaqesohet nga Administratoriet e saj, nga te dy se bashku ose vec e vec. Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.
- 16.2 Administratori i nje shoqerie meme nuk mund te zgjidhet administrator i Shoqerise se kontrolluar, dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- 16.3 Administratoret e Shoqerise do te jete:

Z. Fitim Ali Fazliu , i biri i Aliut dhe i Igaballes, lindur ne 17 Shtator 1976 në Prishtin, me adrese banimi Nebih Gashi nr.34, Kalabria Prishtin 10000 Prishtine Kosov, me kombsi shqiptare, mbajtes i pasaportes me numer 523583901.	
---	--

- 16.4 Kohezgjatja e funksionit te Administratorit (eve) eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore(dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Regjistrimit), me te drejte ripertesitje te ketij mandati.
- 16.5 Cdo Ortak ka te drejte qe te propozoje nje nga Administratoret. Administratori (et) zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ne perputhje me nenin 12.4, me siper, dhe/ose nga marreveshja e Ortakeve.
- 16.6 Menjehere pas pranimit te emerimit, Administratori(et) njohin ne forme te shkruar se mardhenia e tyre me Shoqerine ndertoht mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje rezolute te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.
- 16.7 Ortaku/Ortaket kane te drejten te shkarkojne Adminsitratorin (et) me shumice te thjeshte votash. Ne rast shkarkimi te njerit dhe/ose te gjithe Administratoreve, Administratori(et) e rinj do te emerohen sipas procedures se pershkruar ne Seksion 16.5 dhe marreveshjes se Ortakeve.
- 16.8 Administratori (et) vepron ne lidhje me cdo ceshtje te Shoqerise qe nuk eshte caktuar nen autoritetin e Ortakeve ne perputhje me kete Statut, dhe cdo apo te gjithe vendimeve te Ortakeve si dhe ligjeve te zbatueshme.

- 16.9 Nëse Shoqëria do të ketë me shumë se një Administrator dhe ato nuk arrijnë të bien në një mendim të përbashkët lidhur me mbylljen, përfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve të tjera, çështja do të referohet tek Ortaket të cilët vendosin në përputhje me Seksionin 12, në varesi të çështjes që do të shqyrtohet.
- 16.10 Nëse Shoqëria do të ketë me shumë se një Administrator dhe ato nuk arrijnë të vendosin së bashku, në një masë të tillë sa Ortaket të gjykojnë që kjo mosmarreveshje e vazhdueshme pengon seriozisht operimin normal të aktivitetit të Shoqërisë, Ortaket me shumicë të thjeshtë të votave vendosin për zëvendësimin e njerit ose të të dy Administratorëve. Administratori(et) pasues emerohen në përputhje me Seksionin 16.5 dhe me marreveshje të Ortakëve.
- 16.11 Shpenzimet e xhepit të justifikuar në mënyrë të arsyeshme nga Administratori(et) dhe të kryera në funksion të mbarevajtjes së operimit të Shoqërisë rimbursohen nga Shoqëria.
- 16.12 Për aq sa është e lejueshme dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar ose me çdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kanë fuqi vepruese, Administratori(et) kanë të drejtën të marrin vendime në lidhje me detyrat e tyre pa qenë fizikisht present në Shqipëri ose në ambientet e Shoqërisë. Shoqëria u rimburson Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjatë udhetimeve lidhur me prezencën e detyrueshme të Administratorit(eve) në vende që nuk janë brenda qytetit të residences së Administratorit(eve).

#### **Neni 17      Kompetencat dhe detyrimet**

- 17.1 Kompetencat e Administratorëve (të dy së bashku ose secëri) në kuadër të përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë:
- Thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, në rastet e specifikuar në nenin 13.
  - Menaxhimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë nëpërmjet implementimit të politikave dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
  - Përfaqësimin e Shoqërisë.
  - Kujdesin për mbajtjen në mënyrë të pershtatshme të dokumentave dhe librave kontabel të Shoqërisë.
  - Përgatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve që i paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme.
  - Krijimin e një sistemi paralajmërimi për rrethanat që kërcenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë.



- Kur është e nevojshme, kryejnë regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe ose organeve të tjera, personalisht ose nepermjet të autorizuarve nga ai.
- Raportimin përpara Asamblesë së Përgjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendesi të vecante për veprimtarinë e Shoqërisë.
- Kryerjen e detyrave të tjera të caktuara në ligj dhe nga Ortakët.

17.2 Administratori(et) të dy se bashku ose veç e veç mbikqyrin dhe sigurojnë që zyrtarët, agjentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë. Administratori(et) duhet të raportojnë tek Ortakët në lidhje me personat të cilët emerohen nga Ortakët.

### **Neni 18 Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia**

- Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nënëve 14,15,16,17 e 18 të Ligjit të Shoqërive, Administratorët (et) detyrohen:
  - (i) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në këtë Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në teresi, duke i kushtuar vëmendje të vecante ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
  - (ii) të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - (iii) të vlerësojnë me përgjegjësi ceshtjet për të cilat merret vendim;
    - të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
    - të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit të shoqërive;
    - të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshëm
- Administratorët gjatë kryerjes së detyrave të tyre përgjigjen kundrejt shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprim apo mosveprim është kryer në mirëbesim.
- Në rast të shkeljes së detyrës dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 të këtij neni, Administratorët janë të detyruar të demshperblejë Shoqërinë, për demet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë Shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të vertetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

- Ne vecanti, Administratoret jane te detyruar te demshperbleje Shoqerine, per demet, neqoftese ne kundershtrim me Ligjin e Shoqerive kryen veprimet e meposhtme:
  - i kthen Ortakeve kontributet;
  - i paguan Ortakeve interesa apo dividente;
  - i shperndan asetet Shoqerise;
  - lejon qe Shoqeria te vazhdoje aktivitein e saj, kur duhet ta kishte parashikuar qe kjo e fundit nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet e saj;
  - jep hua

## KAPITULLI VI

### Administrimi Financiar i Shoqerise

#### **Neni 19. Eksperti Kontabel i Autorizuar**

- 19.1 Nese kerkohet, Ortaket duhet te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar ne numrin dhe kohezgjatjen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar.
- 19.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## KAPITULLI VII

### Aktiviteti Shoqerise

#### **Neni 20. Viti ekonomiko-financiar**

- 20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

#### **Neni 21. Mbajtja e Llogarive**

- 21.1 Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

#### **Neni 22. Llogaritja dhe Shprendarja e Fitimit**



- 22.1 Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, marreveshjen e Ortakeve dhe me ligjet e zbatueshme.
- 22.2 Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.
- 22.3 Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:
- asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
  - Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;
- Administratori (et) leshon nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.
  - Administratoret pergjigjet ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

## KAPITULLI VIII

### Modifikimi i Formes Ligjore; Prishja

#### **Neni 23. Modifikimi i Formes Ligjore**

- 23.1 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 12 ketu dhe ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.
- 23.2 Shoqeria e re do te permbush te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

#### **Neni 24. Prishja e Shoqerise**

- 24.1 Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:
- si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- hapje e nje procedure falimentimi;

- nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- me vendim gjykate;
- per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

24.2 Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njoftimin vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

## KAPITULLI IX

### Te ndryshme

#### Neni 25. Largimi i Ortakut

25.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive

#### Neni 26 Ligji i zbatueshem

26.1 Kjo marreveshje rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjet shqiptare.

#### Neni 27. Zgjidhja e mosmarreveshjeve

27.1 Mosmarrveshjet qe mund te lindin ndermjet ortakëve apo ndermjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

#### Neni 28 Konfidençialiteti, ruajtja e sekretit dhe maredheniet e punes

28.1 Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga Administratori(et) dhe/ose Ortaket e kesaj shoqerie.

28.2 Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne



28.1 Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te trefet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga Administratori(et) dhe/ose Ortaket e kesaj shoqerie.

28.2 Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**Neni 29      Librat e shoqerise**

29.1 Pavec sa percaktohet ne legjislacion Shoqeria mban librat e meposhtem:

- (i) Libri i Ortakeve
- (ii) Libri i Mbledhjeve
- (iii) Libri i vendimeve te Asamblese se Pergjithshme dhe Administratorit (eve)
- (iv) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

29.2 Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

**Neni 30      Te tjera**

30.1 Cdo ceshtje tjetër, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite dhe legjislacioni shqipetar ne fuqi.

30.2 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet nga Ortakët e Shoqërisë, sot më datë 06.02.2024, në gjuhën shqipe në katër kopje.

**ORTAKET THEMELUES**

Z.Fitim FAZLLIU



Z. Kujtim FAZLLIU

